



DREJTUESIT



KRYETARJA

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova (Bullgari)

Kryetari i Dhomave të Specializuara të Kosovës është përgjegjës për administrimin gjyqësor të Dhomave të Specializuara dhe për funksione të tjera që i akordon Ligji. Kryetari përfaqëson Dhomat e Gjykatësve. Një nga detyrat kryesore të Kryetarit është caktimi i gjykatësve nga Regjistri i Gjykatësve ndërkombëtarë në përbërje të një paneli dhe në çështje gjyqësore para Dhomave të Specializuara. Kryetari i Dhomave të Specializuara kryen njëkohësisht detyrën e kryetarit të panelit të Gjykatës Supreme në çështjet ku merr pjesë.

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova u emërua Kryetare më 14 dhjetor 2016, detyrë të cilën e filloi më 12 janar 2017. Kryetare Trendafilova, e cila më parë ka shërbyer si gjykatëse në Gjykatën Penale Ndërkombëtare (2006-2015), është një gjykatëse, juriste dhe akademike e shquar me përvojë të madhe në fushën e të drejtës penale ndërkombëtare, të drejtës dhe procedurës penale dhe të drejtës për të drejtat e njeriut.



ADMINISTRATORJA

Dr. Fidelma Donlon (Irlandë)

Administratori është autoriteti më i lartë administrativ i gjykatës, si edhe në krye të shërbimeve mbështetëse gjyqësore. Administratori është përgjegjës për funksione të nevojshme për veprimtarinë e Dhomave të Specializuara, si mbrojtja, pjesëmarrja e viktimave, njësia e paraburgimit dhe avokati i popullit, si edhe për njësi të tjera mbështetëse, si njësia juridike, njësia për administrimin gjyqësor, njësia e shërbimeve gjuhësore, njësia e informimit dhe e komunikimit me publikun dhe administrata. Administratori gjithashtu administron subvencionin e drejtpërdrejtë të BE-së, nëpërmjet të cilit financohet buxheti i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

Dr. Fidelma Donlon është Administratore që nga prilli 2016. Si administratore e lartë gjyqësore e sprovuar dhe akademike dhe juriste e respektuar, dr. Donlon ka shërbyer në Gjykatën Speciale për Sierra Leonen, në Gjykatën për Krime të Luftës të Bosnjë-Hercegovinës dhe Zyrën e Përfaqësuesit të Lartë në Bosnjë-Hercegovinë. Që nga viti 2015, ajo gjithashtu drejtoi themelimin strategjik dhe organizativ të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

GJYKATËSIT



Më 7 shkurt 2017, në bazë të rekomandimeve të një Paneli Përzgjedhës të Pavarur, shefi i Misionit të BE-së për Politikë të Përbashkët të Mbrojtjes dhe Sigurisë në Kosovë (EULEX) emëroi gjykatësit në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtar. Gjykatësit janë fizikisht të pranishëm në Dhomat e Specializuara vetëm sipas nevojës, me kërkesë të Kryetares së Dhomave të Specializuara, për ushtrimin e detyrave të caktuara.

Dhomat të cilat i përkasin dhe pasqyrojnë çdo nivel të sistemit gjyqësor të Kosovës, përbëhen prej paneleve në vijim: gjykatës individualë të cilët kryejnë detyrat e gjykatësit të procedurës paraprake; trupa gjyqës

të përbërë prej tre gjykatësish (dhe një gjykatësi rezervë); panele të Gjykatës së Apelit të përbëra prej tre gjykatësish; panele të Gjykatës Supreme të përbëra prej tre gjykatësish; panele të Gjykatës Kushtetuese të përbëra prej tre gjykatësish; dhe gjykatës individualë të tjerë të nevojshëm për kryerjen e funksioneve të Dhomave të Specializuara.

Në përputhje me Ligjin për themelimin e Dhomave të Specializuara, gjykatësit janë të pavarur në kryerjen e detyrave të tyre dhe nuk marrin e as kërkojnë udhëzime prej asnjë qeverie ose burimi tjetër.

GJYKATËSIT E DHOMËS SË SPECIALIZUAR TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Në bazë të Ligjit për Dhomat e Specializuara të Kosovës, gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese trajtojnë vetëm referime kushtetuese në lidhje me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.



Gjykatës Vidar Stensland
(Norvegji)



Gjykatës Roland Dekers
(Holandë)



Gjykatëse An Pauër-Ford
(Irlandë)



Gjykatës Antonio Balsamo
Gjykatës zëvendësues
(Itali)

GJYKATËSIT NDËRKOMBËTARË E DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

Gjykatësit caktohen në panele dhe çështje gjyqësore prej Kryetares



Gjykatës Kith Reinër
Nënkryetar
(Britani e Madhe)



Gjykatës Çarls L. Smith, III
(Shtetet e Bashkuara të Amerikës)



Gjykatëse Kristinë
van den Vajngart
(Belgjikë)



Gjykatëse Mishelë Pikar
(Francë)



Gjykatës Tomas Laker
(Gjermani)



Gjykatës Emilio Gati
(Itali)



Gjykatës Mihael Bolander
(Gjermani)



Gjykatës Kai Ambos
(Gjermani)



Gjykatës Kenet Roberts
(Kanada)



Gjykatëse Mapi Feld-Folia
(Holandë)



Gjykatës Kristof Barte
(Gjermani)



Gjykatës Vladimir Mikula
(Republika Çeke)



Gjykatës Gënel Metro
(Zvicër)



Gjykatës Nikola Giju
(Francë)



Gjykatës Andres Parmas
(Estoni)